



PLAN

për zhvillim të qëndrueshëm.

Shtylla IV / 3

SHFRYTËZIMI I BURIMEVE

Analizë politikash në mbështetje të
procesit të elaborimit të SKZH-së

Zyra për Planifikim Strategjik
e Zyrës së Kryeministrit





PLAN

për zhvillim të qëndrueshëm.

Shtylla IV / 3

SHFRYTËZIMI I BURIMEVE

Analizë politikash në mbështetje të
procesit të elaborimit të SKZH-së

Zyra për Planifikim Strategjik
e Zyrës së Kryeministrit

.....

Përmbajtja

Lista e shkurtesave	4
Thekset kryesore nga kjo analizë	5
Qëllimi	6
Arsyetimi	6
Vlerësimi i situatës	6
UJËRAT	7
PYLLTARIA.....	8
MINIERAT	8
Politikat aktuale.....	10
UJËRAT	10
PYLLTARIA.....	10
MINIERAT	11
Definimi i problemit.....	11
UJËRAT	11
PYLLTARIA.....	13
MINIERAT	13
Rekomandime për masat kryesore të politikave.....	14
Tabela e Figurave	18
Lista e Tabelave.....	19
Bibliografia	20

.....

Lista e shkurtesave

CAPEX	Shpenzimet kapitale
KPMM	Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale
KEK	Korporata Energjetike e Kosovës
AKP	Agjencia e Privatizimit e Kosovës
MBPZHR	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
MZHE	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
MASHT	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
SKZH	Strategjia Kombëtare për Zhvillim
ZKM	Zyra e Kryeministrit
NPP	Ndërmarrjet në pronësi publike
ZPS	Zyra e Planifikimit Strategjik

.....

Thekset kryesore nga kjo analizë

- *Kapacitetet për furnizim me ujë në Kosovë aktualisht kanë tejkaluar kufijtë e tyre.*
- *Rëndësia e lartë strategjike e pyjeve për Kosovën si një vend me popullsi me dendësi të vogël me dimra të ftoftë dhe një sektor të konsiderueshëm të përpunimit të drurit vëshirë se mund të nënvlerësohet*
- *Kosova është shumë e pasur me minerale energjetike (qymyr), por gjithashtu edhe e pasur në minerale metalike (metalet pa ngjyra, me ngjyra dhe metalet e çmuara), sikurse dhe mineralet jometalike dhe të ndërtimit.*
- *Mungesa e ujit mund të zgjidhet duke reduktuar humbjet teknike dhe komerciale te kompanive rajonale të furnizimit me ujë, riparuar rrjetet e furnizimit dhe shtrirë sistemin e ujitjes.*
- *Shfrytëzimi i qëndrueshëm dhe menaxhimi i pyjeve duhet adresuar parimisht duke krijuar koordinim më të mirë ndërmjet pronarëve të pyjeve, ristrukturuar dhe/ose privatizuar të Ndërmarrjeve të Pyjeve në Pronësi Shoqërore dhe reduktimi i shfrytëzimit illegal.*
- *Shfrytëzimi i plotë i potencialit të minierave mund të arrihet parimisht duke zgjidhur problemet e strukturave të pronësisë të resurseve natyrore, adresimi i mangësive në rregullimin e tregut dhe kapacitetin administrative, lidhjen e minierave me zhvillimin e shtyllave industrial, përkrahja e investimeve në infrastrukturë dhe adresimi i lidhjeve ndërsektoriale.*

.....

Qëllimi

Qeveria e Kosovës ka iniciuar punën në hartimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim (SKZH), Kosova 2020. SKZH e Kosovës është një dokument kryesor për vizionin strategjik për zhvillimin e vendit deri në vitin 2020. Ai prioritetizon politikat me qëllim të arritjes së progresit të prekshëm në fushat të cilat pengojnë rritjen ekonomike dhe kohezionin social. Modeli i rritjes ekonomike dhe kohezionit social për Kosovën, i shtjelluar nga ky projekt ka dalë me një listë të prioriteteve potenciale të politikave të cilat janë drejtpërdrejt të lidhura me objektivin strategjik të arritjes së normave vjetore të rritjes prej 7-8% deri në vitin 2020 duke zhbllokuar potencialin ekonomik të punës dhe burimeve natyrore në mënyrë që të maksimizohet prodhimi dhe të zbutet varfëria. Lista e lartpërmendur e prioriteteve të politikave është bazuar në analizën mbi pengesat për zhvillim ekonomik të Kosovës dhe është harmonizuar me prioritetet nga reformat strukturore të identifikuara në kuadër të Programit të Reformave Ekonomike të Republikës së Kosovës.

Arsyetimi

Vlerësimi i situatës

Kosova ka nevojë që në mënyrë të vazhdueshme të ketë norma të larta të rritjes ekonomike në vitet e ardhshme në mënyrë që të nxë hapin me rajonin dhe me Evropën si tërësi në kuptimin e zhvillimit social dhe ekonomik. Këto normal të larta të rritjes kërkojnë një rritje të shfrytëzimit të burimeve natyrore dhe njerëzore të vendit. Politikat që nevojiten për të siguruar shfrytëzimin më të mirë të burimeve janë shtjelluar nëpërmjet notave të ndryshme të politikave sektoriale të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim (SKZH).

Sidoqoftë, ndjekja e politikave të orientuara drejt rritjes do të shkaktojë shumë faktorë të jashtëm negativë, të cilët, nga ana tjetër, krijojnë rreziqe për varfërimin e burimeve dhe pra paqëndrueshmërinë e zhvillimit në kohë afatgjatë. Kjo për shkak se burimet vetvetiu janë të kufizuara dhe shpesh të prekshme ndaj tronditjeve, meqenëse ato janë të varura në ekosistemet komplekse. Politikat qeveritare me qëllime të mira mund të ndikojnë, për shembull, ngritjen e shtyllave shumë të nevojshme industriale që krijojnë vende të punës për një rajon të caktuar. Por të njëjtat firma prodhuese që krijojnë të ardhura për disa mund të ndotin tokën dhe ujërat e përdorura nga fermerët lokalë, duke shkakuar kështu faktorë të jashtëm mjedisorë dhe socialë.

Një Strategji Kombëtare për Zhvillim, gjithëpërfshirëse, ka nevojë të sigurohet që politikat e orientuara drejt rritjes të balancohen nga masat që synojnë të garantojnë qëndrueshmërinë e burimeve kryesore dhe natyrore strategjike, mbi të cilat bazohet rritja ekonomike dhe mirëqenia sociale. Vëmendje e veçantë në këtë drejtim iu është dhënë ujërave, pyjeve dhe burimeve minerale, për arsytet e dhëna më poshtë.

Madje edhe me bazën aktuale mjaft të ulët të prodhimit industrial dhe bujqësor, **kapacitetet për furnizim me ujë në Kosovë aktualisht kanë tejkaluar kufijtë e tyre.** Kjo kryesisht shkaktohet nga dendësia e lartë e popullsisë, dekadat e mungesës së investimeve në infrastrukturën e ujërave dhe rajonet me disavantazhe natyrore në kuptimin e burimeve të ujërave. Meqenëse Kosova do të synojë rritjen e ekonomisë së saj nëpërmjet një rritjeje të prodhimit industrial dhe bujqësor, kjo do të nënkuptojë rritjen e kërkesës për ujë. Burimet e pamjaftueshme të ujit pra rrezikojnë të bëhen një nyje serioze, si për rritjen në aktivitetet ekonomike, ashtu dhe për shfrytëzimi shtëpiak. Implikimet ekonomike dhe sociale për këtë janë të konsiderueshme.

Rëndësia strategjike e pyjeve për **një vend me popullsi me dendësi të vogël me dimra të ftoftë dhe një sektor të konsiderueshëm të përpunimit të drurit vështirë se mund të nënvlerësohet.** Kërkesa për drunjt, e shkakuar nga shfrytëzimi për ngrohje dhe përpunimi i mëtutjeshëm në industri, aktualisht është duke bërë presion të madh mbi rezervat aktuale të pyjeve për shkak se normat e prerjeve (legale dhe ilegale) janë shumë më të larta sesa norma e regjenerimit të pyjeve.

.....

Zhvillimi i mëtutjeshëm i industrisë së përpunimit të pyjeve – një nga sektorët e identifikuar me perspektivë të mirë për rritje – mund ta keqësojë më tutje problemin. Pasojat e jashtme të kësaj mund të jenë shumë të këqija. Në nivelin mikro-mjedisor, shpyllëzimi mund të çrregullojë ekosistemin dhe kafshët e egra, shkaktojë erozionin e tokës dhe rrit gjasat për përmytje, meqenëse pemët e absorbojnë ujin. Shpyllëzimi mund të ketë impakt të madh ekonomik dhe social mbi zonat që rrethojnë pyjet, veçanërisht fermat. Ky rrezik keqësohet më tej në kohën kur tokat bujqësore do të jenë nën rrezik nga ciklet e motit ekstrem për shkak të ndryshimeve klimatike.

Burimet minerale, në anën tjetër, janë një nga pasuritë më të mëdha të Kosovës për zhvillim ekonomik dhe shfrytëzimi i tyre i qëndrueshëm nuk kuptohet vetëm në termat e ndikimeve të tyre mjedisore – megjithëse ato janë mjaft të rëndësishme – por **në mënyrën më efikente dhe më të leverdishme të shfrytëzimit të tyre për qëllimet e rritjes**. Rezervat e mëdha të linjtit, nikelit, zinkut, etj., janë shtylla të gjigantëve ekzistues dhe potencial industrialë, duke siguruar të ardhura për komunitete të tëra. Impakti tragjik i kolapsit të Trepçës, një gjiganti industrial i cili kishte punësuar rreth 20 mijë njerëz, mbi ekonominë e rajonit të Mitrovicës, aktualisht një nga rajonet më të varfra në Kosovë, tregon se sa e rëndësishme është që të kemi politikat të hartuara në mënyrë strategjike që do të lejonin industrinë e bazuara në burime për të funksionuar në baza të qëndrueshme.

UJËRAT

Spektori i ujërave në Kosovë është relativisht shumë mirë i konsoliduar me mekanizmat e qeverisjes që janë duke iu afruar standardeve të BE-së. Ekzistojnë 7 kompani rajonale të ujërave që kanë statutin e NPP-ve (të drejtat e pronësisë të ushtruar nga MZHE) dhe që mbikëqyren dhe rregullohen nga Zyra e Rregullatorit të Ujërave dhe Mbeturinave.

Rregullimi ekonomik është duke punuar meqenëse tarifatat janë duke u rritur në shkallë më të lartë sesa inflacioni, duke iu mundësuar kompanive të ujërave që të financojnë operimin e tyre në mënyrë të qëndrueshme, por nivelet e tyre aktuale nuk janë duke mundësuar zëvendësimin e pasurive të tyre ose zhvillimin substancial të infrastrukturës. Për më tepër, një problem i ngjashëm sikurse në sektorin e energjisë është i pranishëm edhe në sektorin e ujërave, meqenëse mbledhja e të hyrave është shumë e ulët.

Pjesa e ujit pa të ardhura (jo të faturuar/të prodhuar) është shumë e lartë në 57% dhe norma aktuale e mbledhjes vetëm 71% (e mbledhur/faturuar). Kjo i lë kompanitë e ujërave me vetëm 30% të mbledhjes të të hyrave për ujin e prodhuar në mesatare. Kjo normë është jashtëzakonisht e ulët dhe duhet të gjendet një zgjidhje në mënyrë urgjente. Ky problem pjesërisht mund t'i atribuohet humbjeve teknike, por shumica e humbjeve janë komerciale, p.sh. kyçjet ilegale, leximi i gabuar i matësve.

Kosova ka një klimë kontinentale dhe mesatarja e të reshurave për person është vetëm 41% e mesatares rajonale (kryesisht për shkak të densitetit të lartë të popullsisë). Po ashtu, deponimi në formë të rezervuarëve nuk është i lartë, për kokë banori është vetëm 42% e mesatares rajonale. Nëse i kombinojmë këta dy faktorë mund të konkludojmë që Kosova është mjaft e rrezikuar për sa i përket thatësirave dhe shkurtimeve të ujit, këto rreziqe kanë ndodhur së fundmi (prill/maj 2014) dhe vendi nuk është i përgatitur të ballafaqohet me to në të ardhmen.

Në këto kushte investimi i mëtutjeshëm në infrastrukturën për shpërndarjen e ujit nuk është duke e zgjidhur problemin më urgjent që është mungesa e ujit. Kostoja e investimeve në rrjetin e shpërndarjes së ujit nuk barazohet me një rritje në të ardhurat për shkak të tarifave relativisht të ulëta (kthimin negativ në investim) dhe karakteri kryesisht komercial, jo teknik, i humbjeve gjatë shpërndarjes. Investimi duhet që kryesisht të fokusohet në mbajtjen dhe deponimin e ujit. Konsumimi i tepërt i ujit duhet po ashtu të gjejë zgjidhje nëpërmjet stimuljeve për kursime, veçanërisht në Pejë dhe Mitrovicë që janë më të pasur me ujëra.

Komuniteti ndërkombëtar është duke asistuar qeverinë kryesisht duke zgjidhur çështjen e ndotjes së ujit

.....

.....

nëpërmjet investimeve në sistemet e kanalizimit dhe objektet e trajtimit të ujërave të zeza. Ndërsa studimet e fizibilitetit janë finalizuar për shumë fabrika të trajtimit të ujërave të zeza dhe janë paraparë investimet në këtë sektor, megjithatë përfitimet ekonomike vihen në pikëpyetje. Sikurse me rrjetin e shpërndarjes së ujërave, kjo po ashtu nuk zgjidh rrezikun kryesor të shkurtimeve të ujit me të cilin ballafaqohet Kosova. Për më tepër, operimi i këtyre kapaciteteve – nëse ato e respektojnë parimin kryesor të ripërtëritjes – do të kontribuojë në mënyrë domethënëse në rritjen e tarifave, që mund të jenë problematike duke pasur parasysh eficientën e tanishme të ulët të mbledhjes së të ardhurave. Kjo do të përkeqësonte më tej qëndrueshmërinë financiare të kompanive të ujërave, të cilat tanimë janë duke luftuar për të mbajtur programet e tyre të investimeve kapitale.

Mund të pritet presion në rritje ndërmjet të reshurave natyrore dhe konsumimit të ujit nga zhvillimi i sektorit bujqësor. Aktualisht eficientia e sistemeve të ujitjes është shumë e ulët – sasia e ujit për hektar të tokës së ujitur është shumë më e lartë sesa në vendet e tjera – dhe ato mbulojnë vetëm zonat e kufizuara të fshatrave. Zhvillimi i sistemeve të ujitjes pa investime të mëtutjeshme në mbajtjen e ujit mund të këshillohet vetëm në pjesën parëndimore të vendit, ku nuk është burim i kufizuar.

PYLLTARIA

Pyjet mbulojnë një zonë totale prej 464800 ha ose 42.6% të hapësirës totale të tokave të Kosovës (1090800 ha). Duke u bazuar në inventarin e pyjeve, kjo paraqet një rritje prej 5% për një periudhë prej 10 viteve. Nga hapësira totale e pyjeve, 278880 ha (60%) klasifikohen si tokë pyjore publike dhe 185920 ha (40%) si tokë pyjore private. Pyjet e mbrojtura mbulojnë një hapësirë prej 59600 ha (12%).

Vëllimi total i tokave pyjore vlerësohet të jetë rreth 33.5 milionë m³. Nga ky vëllim, 25.9 milionë m³ janë drunj me diametër prej >7 cm në lartësinë e trungut të tyre, 14.5 milionë m³ janë drunj me një diametër >7 cm. Nga fondi i përgjithshëm i drunjëve me diametër >7 cm në lartësinë e trungut të tyre, 14.4 milionë (35%) ndodhen në zonat e mbrojtura, ku është e mundshme vetëm shfrytëzimi i kufizuar.

Rritja vjetore e drunjëve me diametër >7 cm në lartësinë e trungut të tyre vlerësohet të jetë 1.556 milionë m³. Prerja vjetore e qëndrueshme dhe e lejueshme vlerësohet të jetë 1.446 milionë m³, ndërsa mesatarja e prerjes aktuale vjetore është 1.56 milionë m³ (1.0 milionë pyje publike dhe 0.56 milionë pyje private). Kjo nënkupton që norma aktuale e shfrytëzimit të drunjëve nga pyjet nuk është e qëndrueshme. Për më tepër, më shumë se 90% e mbushjeve vjetore nuk realizohen sipas rregulloreve, me përfaqësimin 59% që marrin pjesë në pyjet publike dhe 34% në pyjet private. Sipas anketave 40% e tokave pyjore dhe 29% e tokave pyjore private i nënshtrohen aktiviteteve të shfrytëzimit të pakontrolluar ose ilegal. Sipas të gjitha standardeve këto figura janë shumë të larta. Për shkak të aktiviteteve të paqëndrueshme, të pakontrolluara ose aktiviteteve të shfrytëzimit ilegal, shumë pyje të reja ose me moshë mesatare janë në një nevojë urgjente të intervenimit në menaxhim, që fillojnë nga pastrimi/rrallimi parakomercial e deri te rrallimi komercial.

Përveç shfrytëzimit të drunjëve, pyjet mund të shfrytëzohet edhe si burime të vlefshme të energjisë së ripërtëritshme nga biomasa. Vlerësimi i biomasës totale në pyjet e Kosovës është 48392 tonë, përderisa mbi tokë ekzistojnë 35746 tonë të biomasës. Meqenëse 36% të fondit ekzistues të drunjëve përqendrohet në zonat e mbrojtura, potenciali real i biomasës përfshin diku rreth 12650 tonë.

MINIERAT

Kosova është shumë e pasur me minerale energjetike (qymyr), por gjithashtu edhe e pasur në minerale metalike (metalet pa ngjyra, me ngjyra dhe metalet e çmuara), sikurse dhe mineralet jometalike dhe të ndërtimit. Vlera e përlogaritur e këtyre burimeve natyrore është ndërmjet 12.5 dhe 25 miliardë euro (Iniciativa Ekonomike për Kosovën, 2013). Sidoqoftë, këto burime vetëm pjesërisht janë kapitalizuar për të shërbyet si burime të rritjes dhe prosperitetit. Ekzistojnë një numër arsyesh duke përfshirë zhvillimet ekonomike globale të vitit 2008, por përfundimisht konteksti i Kosovës, d.m.th. tranzicionet e

.....

përnjëhershme dhe kapacitete e dobëta qeverisëse për burimet kanë qenë faktorë kryesorë për shfrytëzimin minimal të potencialit të minierave.

Kosova radhitet e treta në Evropë në **rezervat e qymyrit-linjtit** përderisa cilësia e qymyrit është shumë e mirë. Linjiti gjendet kryesisht në depozitat e mëdha në tri basenet kryesore (baseni i Dukagjinit, baseni i Kosovës dhe baseni i Drenicës), dhe sipas MZHE-së, Kosova ka më shumë se 12 miliardë tonë qymyr në rezervat gjeologjike. Sidoqoftë, përveç përpjekjeve të vazhdueshme për të ndërtuar kapacitetet e reja të prodhimit të energjisë (Kosova C) dhe kapitalizmit mbi këto burime të qymyrit, ky proces ende nuk ka përfunduar me rezultat pozitiv.¹

Kosova po ashtu është e pasur me **minerale metalike** dhe veçanërisht me plumb dhe zink, që shoqërohen me një pjesë modeste edhe me argjend. Sipas të dhënave të MZHE-së mbi rezervat, vlera monetare bruto e rezervave të plumbit dhe zinkut, në çmimet aktuale (LME 3 pika e blerësit/shitësit) vlerësohet të jetë më shumë se 8 miliardë euro.

Sa i përket **mineraleve të tjera** potenciale, shumica e burimeve të rëndësishme menaxhohen nga Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP). Disa burime, Ferronikeli dhe Sharrçemi, janë privatizuar dhe kanë tërhequr investues të huaj, secila prej rreth 30 milionë euro. Në një rast të fundit, AKP-ja ka paditur minierën e mëhershme të privatizuar të magnezit për shkak se zotimet për investim nuk u patën bërë për marrëveshjen e privatizimit. Kjo e fundit është shenjë e qartë e projektimit jo të mirë të tenderit që ka rezultuar me një investues të dobët dhe humbje të potencialit për zhvillim.

Sektori i minierave në Kosovë ka një histori afatgjatë dhe ka përjetuar një numër ndryshimesh politike dhe ekonomike në të kaluarën më të vonshme që kanë kontribuar në situatën aktuale të nënshfrytëzimit të potencialit të tij. Sidoqoftë, adoptimi i një kornize të re legjislative si dhe përpjekja e vazhdueshme për ristrukturimin dhe modernizimin e minierave ekzistuese janë një hap në drejtimin e duhur.

Kosova ka një numër të madh të minierave aktive që janë në operim dhe që kanë dëshmi të evidentuara për përkrahjen e zhvillimit ekonomik të vendit. Ndërmjet tyre, më të rëndësishme janë ato si në vijim:

1. **Trepça** (nën administrimin e AKP-së) – përfshin shumë miniera, flotacionin, metalurgjinë dhe industrinë kimike. Ajo aktualisht është funksionale vetëm me disa operate të kufizuara, katër minierat (miniera “Trepça” në Stantërg, minierat e Cernacit, minierat e Novobërdës).
2. **Minierat e magnetit të Goleshit dhe Strezovcit** – janë shfrytëzuar për të prodhuar magnez rezistues kaustik për klientët nga Jugosllavia e mëparshme por gjithashtu edhe eksportet në vendet e tjera të Ballkanit dhe Italisë. Në minierën e Magurës, dokumentet arkivore tregojnë se ndërmjet viteve 1964 dhe 1992 janë shfrytëzuar rreth 1250000 tonë magnez. Shfrytëzimi i magnezit nga minierat e Strezovcit filloi në vitin 1956. Përderisa në vitin 1973, u nis linja e prodhimit të reparacionit. Shfrytëzimi i burimeve të magnezit bëhet me metodat sipërfaqësore dhe nëntokësore. Këto dy miniera janë privatizuar.
3. **CoFerronikeli i Ri** – hulumtimet në Kosovë për zbulimin e depozitave të nikelit kanë filluar që në vitin 1961. Përderisa shfrytëzimi i xeheve të nikelit – shkrirja dhe përpunimi i xeheve dhe përfitimi i aliazheve Fe – NiCo filloi në vitin 1984. Dy miniera kanë operuar brenda Ferronikelit me metoda sipërfaqësore (Çikatova dhe Gllavica). Gjatë viteve 1984-1999 janë shfrytëzuar 7092090 xehe të nikelit me 21.1%, përderisa nga viti 1984 deri në vitin 1997 janë prodhuar 36728 tonë metal të nikelit. Pas vitit 1997, shkrirësi i Ferronikelit ishte jashtë funksionit. Ferronikeli u privatizua në fund të prillit 2006 nga IMR Alferon. Pas privatizimit, Ferronikeli ka afro 1000 punëtorë.

¹Struktura e projektit ka ndryshuar disa herë. Aktualisht, faza e dytë e procesit të tenderimit është duke ndodhur por ka pritje të larta për sukses të saj. Data e ofertave për aplikim është shtyrë për dhjetor 2014 dhe kjo i atribuohet formimit të vonshëm të qeverisë. Mbetet të shihet nëse investuesit janë të gatshëm të angazhohen në strukturën e tanishme. Burimet e qymyrit, minierat ekzistuese, janë të menaxhuara nga KEK-u, Divizioni i Qymyrit, përderisa rregullat në tenderin aktual kanë paraparë rregullim afatgjatë të blerjes/shitjes.

-
4. **Boksitet e Kosovës** – kryesisht për shfrytëzimin e boksitit me qasje sipërfaqësore filluan aktivitetet e tyre që në vitin 1966. Para mbylljes së minierës në vitin 1990, kjo minierë ka pasur një prodhim vjetor deri në 100 mijë tonë boksit. Në vitin 1989, kjo minierë ka pasur 516 punëtorë, përderisa në vitin 1999, pas luftës ka pasur vetëm 340 punëtorë që janë kthyer në punë. Për shkak të humbjeve të tregut, punëtorët kanë kaluar në prodhimin e gurëve gëlqerorë me synimin që të përgatiten për shfrytëzimin e boksitit. Kompania është në proces të privatizimit dhe ende është funksionale.
 5. **Miniera e cementit e SharrCem-it** – ka qenë operative si një kompani me përgjegjësi të kufizuara e komercializuar me marrëveshje në mes UNMIK-ut dhe kompanisë zvicerane Holcim për një periudhë nga viti 2000 e deri në vitin 2010, nën monitorimin e AKP-së. Në vitin 2010, Bordi i Drejtorëve i AKP-së, ka miratuar privatizimin e ndërmarrjeve të komercializuara duke përfshirë edhe privatizimin e “SharrCem’it”. Kapaciteti vjetor i prodhimit në fabrikë është 0.6 milionë tonë të cementit.
 6. **Korporata Energjetike e Kosovës (KEK Sh.A)** operon me minierat e saj të boksitit që shërbejnë si burim energjie për termocentralet e operuara nga kompania.

Politikat aktuale

UJËRAT

Ministritë udhëheqëse në sektorin e ujërave janë Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural. Ekziston po ashtu edhe Këshilli ndërmintor i Ujërave në Zyrën e Kryeministrit që koordinon aktivitetet e të gjitha organeve qeveritare.

Është themeluar dhe është plotësisht funksionale Zyra e Rregullatorit të Ujërave dhe Mbeturinave, me qëllim të sigurimit të autoritetit rregullativ dhe pavarësisë. Korniza rregullative në sektorin e ujërave është relativisht e zhvilluar mirë dhe me bazën ligjore që është afruar me standardet e BE-së. Sa i përket organizatave të tregut, ekzistojnë 7 kompani rajonale që kanë statutin NPP (pronësia e përfaqësuar nga MZHE).

Strategjitë kryesore qeveritare në sektor janë ende të pazhvilluara, por do të përfshijnë:

- Strategjia Kombëtare e Kosovës për Ujërat 2015-2038, Versioni draft
- Një Strategji e re për Ujitjen në Kosovë, Versioni draft

Kjo notë e politikës i merr parasysh versionet draft të këtyre dokumenteve.

PYLLTARIA

Ligji për Pylltarinë dhe një numër direktivash administrative formojnë kornizën ligjore në pylltari. Në përgjithësi kjo kornizë ligjore paraqet një bazë të mirë për menaxhimin e shëndoshë të pylltarisë në Kosovë dhe është në përputhje me standardet ndërkombëtare. Megjithatë, çka ka mbetur mbrapa, është paaftësia për të zbatuar këto rregulla dhe rregullore në praktikë, pra, zbatimi i legjislacionit është në një nivel shumë të ulët.

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (dhe Departamenti i Pylltarisë) është organi qeveritar përgjegjës për pylltarinë. Agjencia e Pyjeve të Kosovës (APK) është administrues dhe menaxher i tokave pyjore publike e po ashtu është përgjegjëse për zbatimin e ligjit si në pyjet publike, ashtu dhe ato private.

Strategjia e Pyjeve thekson vështirësitë në menaxhimin dhe mbikëqyrjen e politikave/zbatimin e rregulloreve që rrjedhin nga mungesa e aftësive të stafit, burimeve dhe fondeve si dhe roleve dhe mandateve të paqarta/të diskutueshme.

MINIERAT

Organet kryesore qeveritare përgjegjëse për minierat janë Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) dhe Ministria e Zhvillimit Ekonomik (MZHE). Organi kryesor përgjegjës për rregullimin dhe monitorimin e sektorit të minierave është Komisioni i Pavarur për Minierat dhe Minerale (KPMM).

Fuqitë e KPMM-së dalin nga ligji për minierat dhe mineralet dhe KPMM është përgjegjës për të gjitha çështjet që lidhen me lëshimin, transferimin, suspendimin dhe heqjen e të gjitha licencave të hulumtimit dhe shfrytëzimit. Përgjegjësia e KPMM-së është po ashtu shfrytëzimi optimal i potencialit të minierave dhe mineraleve duke përfshirë kujdesin nga fillimi në fund për standardet sociale dhe të mjedisit.

Qeveria ka adoptuar Strategjinë për Minierat të Republikës së Kosovës 2012-2025 dhe Programin për Zbatimin e Strategjisë për Minierat në Kosovë. Strategjia ka 4 shtylla të përqendruara në (1) tërheqjen e investimeve, (2) ngritjen e kapaciteteve njerëzore dhe institucionale, (3) përfitimet e komunitetit dhe (4) çështjet e mjedisit.

Me përkrahjen e Bankës Botërore, në rrugë e sipër është zhvillimi i një plani sektorial gjithëpërfshirës, strategjik dhe afatgjatë, Strategjia e Kosovës për Zhvillimin e Minierave. Ky është një hap i madh në drejtim të përmirësimit të performancës së sektorit dhe bërjes së minierave një burimi të rritjes ekonomike.

Përveç organizatave qeveritare, është formuar një platformë e OJQ-ve që është aktive në fushën e energjisë, mjedisit dhe shfrytëzimit të burimeve natyrore – Konsorciumi i Shoqërisë Civile të Kosovës për Zhvillim të Qëndrueshëm (KOSID).

Strategjitë qeveritare dhe dokumentet e politikave tjera në fushën e mjedisit dhe planifikimit hapësinor:

- Planifikimi Hapësinor i Kosovës 2011-2020+
- Planifikimi hapësinor me Interes Specifik Ekonomik, Fusha e re e minierave 2010-2020+
- Strategjia dhe Plani i Veprimit për Biodiversitet 2011-2020
- Strategjia për Mbrojtjen e Mjedisit 2013-2022
- Plani i Veprimit për Mjedisin në Kosovë 2013-2017
- Strategjia për Cilësinë e Ajrit 2013-2022
- Plani i Veprimit për Zbatimin e Strategjisë për Cilësinë e Ajrit 2013-2017
- Strategjia për Menaxhimin e Mbeturave 2013-2022
- Plani i Veprimit për Zbatimin e Strategjisë për Menaxhimin e Mbeturave 2013-2017

Definimi i problemit

UJËRAT

Pra, çështjet kryesore që janë zgjidhur nga politikat publike në sektorin e ujërave duhet të jenë:

- Ndalja e mospagimit të mirëmbajtjes së infrastrukturës (ashtu që kompanitë e ujërave të jenë në gjendje të përballojnë programet e tyre CAPEX) – trajtimi i ujërave të zeza nuk ndihmon por do ta përkeqësojë gjendjen
- Zgjidhja e humbjeve të shpërndarjes, por jo nëpërmjet investimit por më tepër qeverisjes (për shkak se natyra e tyre është kryesisht komerciale)
- Rritja e efikasitetit të bujqësisë nëpërmjet zhvillimit të më shumë sistemeve të sofistikuara të ujitjes, por jo duke e përkeqësuar problemin e mungesës së ujërave
- Zgjidhja e kapacitetit të pamjaftueshëm të deponimit (duke ndërtuar rezervuarët e ruajtjes së ujit)

• Menaxhimi i vërshimeve

Disa nga këto kërkojnë investime publike, të pritura që të arrijnë totalin prej 1.53 miliardë euro gjatë periudhës prej 20 viteve. Këto mund të mbulohet pjesërisht nëpërmjet tarifave, pjesërisht nëpërmjet granteve të donatorëve dhe shpërndarjeve të buxhetit. Sidoqoftë, janë të nevojshme analiza të mëtutjeshme para se të fillohet me këtë program investimesh.

Tabela 1 - Kostot e vlerësuara për masat e infrastrukturës së ujërave

Çështja	Synimi afatgjatë	Investimet e përafërta në miliona euro
Deponimi i ujërave – rezervuarëve	Rezervuarë të rinj	250
Shërbimet e furnizimit me ujë	Renovimi dhe zgjerimi	430
Rritja e mbulimit nga ujitja	Rritja e mbulueshmërisë dhe eficiencës	70
Mbledhja dhe trajtimi i ujërave të zeza	Renovimi dhe instalimi	680
Mbrojtja nga vërshimet	Renovimi dhe zgjerimi	100
Nevojat potenciale TOTAL	Të gjitha objektivat	1530

Ekzistojnë njohuri të vogla deri më tani për nevojat dhe lokalizimin potencial të rezervuarëve të deponimit të ujërave. Në vitet e '80-ta u pat zhvilluar një master plan për ndërtimin e rezervuarëve të ujërave për gjithë Jugosllavinë, por me ndryshimin e kontekstit dhe ndarjen e Jugosllavisë, kanë ndryshuar nevojat dhe ky plan ka nevojë të rishqyrtohet mjaft shumë dhe të përshtatet me nevojat aktuale të Kosovës. Nevojitet punë e mëtutjeshme inxhinieringu për të përgatitur projektet dhe duhet të analizohet dhe gjendet mënyra më pak e kushtueshme për zgjidhjen e këtyre çështjeve. Deri në 3 vite do të kalojnë derisa që të sillen projektet në fazën e investimit. Por modelet e investimit po ashtu duhet të merren në konsideratë para se të bëhet problem investimi në kapacitetet e reja, meqenëse disa rajone të caktuara të pasura me ujë (Peja, Mitrovica) nuk janë duke shënuar ndonjë zvogëlim në konsumimin e ujit nëpërmjet masave për eficiencë.

Në rast të mbrojtjes nga vërshimet, duhet të përgatitet një vlerësim i kujdesshëm i kostove dhe përfitimeve të këtyre masave që do përcaktonin nevojën për investimet aktuale në infrastrukturë. Në Strategjinë Kombëtare të Kosovës për Ujërat janë paraqitur llogaritje prej rreth 100 milionë eurosh, por kjo duhet të verifikohet më tutje me analiza të detajuara. Po ashtu, është paraqitur edhe harta e rreziqeve nga vërshimet në Strategjinë e Ujërave, ku janë vlerësuar të gjitha basenet e lumenjve për sa i përket rrezikut nga vërshimet. Në zonat urbane do të ketë nevojë për avancimin e infrastrukturës (drenazhimin), por gjithashtu edhe menaxhimin dhe parandalimin e dëmtimeve ndaj kanaleve lumore dhe duhet të forcohen pendat për vërshime. Një faktor tjetër i rëndësishëm është rregullimi i ndërtimit në zonat me rrezik të lartë dhe menaxhimi i rreziqeve (sistemet e paralajmërimit të hershëm).

Ekziston një plan relativisht i detajuar për objektet e trajtimit të ujërave të zeza, por eficientia e kostos së masave nuk është e mirë, siç përshkruhet më lartë. Investimet publike në këtë fushë nuk duhet të konsiderohen prioritet.

Mbulimi me sistemet moderne eficiente të ujitjes është relativisht i ulët dhe sektori ka nevojë për investime të mëtutjeshme. Ujitja aktuale është duke konsumuar 41% të burimeve ujore në vend përderisa mbulon vetëm 12000 hektarë (1/3 të potencialit). Ekziston një Strategji e re e Ujitjes në përgatitje nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, por ajo ka nevojë të shtjellohet më tutje.

Potenciali për shfrytëzimin e burimeve ujore për energji elektrike të prodhuar nga uji do të shqyrtohet në notën e politikës për energjinë – deponimi me pompim, tregu i përbashkët me Shqipërinë. Qasja e përgjithshme ndaj investimeve në prodhimin e energjisë duhet të jetë – dhënia te sektori privat për ta

.....

zhvilluar, me rregullim të mirë dhe me stimuj ekonomikë (brenda tarifave).

PYLLTARIA

Siç është përshkruar më lartë, niveli aktual i aktiviteteve në menaxhimin e pyjeve nuk është i qëndrueshëm në periudhë afatgjatë. Mund të konsiderojmë këtë si pasojë e menaxhimit të pyllit, mbrojtjes së pamjaftueshme dhe shfrytëzimit nënoptimal të burimeve ujore.

Pyjet private janë karakterizuar nga fragmentimi që rezulton në produktivitet të ulët dhe shfrytëzim joefiçient të tokave pyjore. Madhësia mesatare e pronës pyjore është rreth 1.5 ha dhe kjo hapësirë ndahet më tutje në 2.4 parcela. Kjo strukturë kaq e fragmentuar e pronësisë është duke i kufizuar seriozisht mundësitë për menaxhimin joefiçient të tokës.

Sipas Strategjisë së Pyjeve, ndërmarrjet publike të pyjeve nuk janë funksionale dhe mund t'i nënshtrohen privatizimit. Momentalisht ato janë duke lëshuar vetëm leje për shfrytëzim për operatorët privatë, të cilët e shesin lëndën e parë drunore kryesisht për ngrohje, pa ndonjë vlerë të shtuar. Mungesa e kapacitetit mbikëqyrës dhe administrativ në anën qeveritare është duke rezultuar me shfrytëzimin e të drejtave të bazuar në kritere joformale, të ardhura nënoptimale për shitjen e trungjeve, një treg të drurit që nuk është transparent dhe i parashikueshëm, përdorim të drurit nën vlerën e tij për shkak të shfrytëzimit joligjor dhe mbrojtje të dobët nga zjarri dhe epidemitë e insekteve.

MINIERAT

Qasja në burimet natyrore është një nga faktorët kryesorë që sjellin IHD. Zhvillimi dhe hulumtimi i minierave ekzistuese dhe hapja e atyre të reja duhet që, në një nivel ideal, të rris punësimin dhe standardet e jetesës, sikurse dhe të kontribuojë në rritjen e PKB-së dhe të eksportit. Sidoqoftë, ekzistojnë disa pengesa të mëdha për të shfrytëzuar plotësisht këtë potencial. Një nga ato më të shquara është nevoja për **zgjidhjen e të drejtave pronësore** në mënyrë që të zhbllkohet hulumtimi potencial.

Sipas Komitetit Ndërkombëtar për Minerat dhe Mineralet (2014, Otto/Anketa e Kombeve të Bashkuara për 45 kompani) ekzistojnë 10 faktorë kryesorë në vendimet për investime në miniera. Në rastin e Kosovës, faktorët kryesorë të dukshëm që kanë nevojë për t'u zgjidhur urgjentisht nëpërmjet politikave dhe intervenimeve qeveritare janë:

- Siguria e qiradhënies dhe lejeve,
- Konsistenca e politikave minerale,
- Stabiliteti i kushteve dhe rrethanave,
- Mundësia për të paracaktuar obligimet mjedisore dhe tatimore, dhe
- Udhëheqje e qartë dhe e vendosur politike e projektit.

Një dobësi e mëtutjeshme është **moszhvillimi i kapacitetit administrativ dhe mbikëqyrës**, si në MZHE (në kuptimin e ekspertizës teknike dhe politikave) por kryesisht në KPMM. Janë të domosdoshme përshtatjet e kornizës ligjore në mënyrë që të stabilizohet vendimmarrja që është paralizuar gjatë ngërçit politik. Ajo duhet të ndahet nga politika sa më shumë që është e mundur. Fuqizimi i mëtutjeshëm i kapacitetit administrativ të KPMM-së kërkon investime të caktuara dhe të vazhdueshme në burimet njerëzore sikurse dhe harmonizimin dhe qartësimin e procedurave të vendimmarrjes dhe menaxhimit nëpërmjet zhvillimit të "one stop shop".

Një pikë tjetër e dobët në shfrytëzimin e potencialit të minierave në Kosovë është **vlera e shtuar e operimeve** në sektor. Aktualisht përfitimet për vendin janë të përqendruara vetëm në miniera, duke krijuar punësim me produktivitet mjaft të kufizuar. Nuk ekziston ndonjë politikë që do të synonte

.....

zhvillimin e shtyllave industriale të integruara në mënyrë vertikale.

Përveç kësaj, artikulli me potencial më të lartë për eksport i Kosovës – energjia elektrike – është lënë komplet jashtë planeve qeveritare për momentin për shkak të shqetësimit për mjedisin si për minierat e qymyrit ashtu dhe prodhimin e energjisë elektrike në termocentrale.

Infrastruktura hekurudhore është kyçe që operimi i minierave të jetë efektiv dhe i qëndrueshëm ekonomikisht, dhe ka nevojë për investime shtesë në mënyrë që të shfrytëzohet potenciali për eksport i sektorit. Duke pasur parasysh gjeografinë e Kosovës dhe depozitat e minierave, është kyçe sidomos linja hekurudhore Leshak–Fushë Kosovë–Hani i Elezit (ngarkesa e boshtit 22.5 t/ngarkesa e boshtit dhe ajo longitudinale 7.2 t/m). Po aq e rëndësishme është linja Fushë Kosovë–Klinë, e cila do të mundësonte lidhjen e hekurudhës me autostradën shqiptare dhe portet shqiptare.

Rekomandime për masat kryesore të politikave

1. Shmangia e rreziqeve që rezultojnë nga mungesa e ujit

Sfidat kryesore në sektorin e ujërave janë humbjet në rrjet, mungesa e masave të efijencës për konsumim, mungesa e kapaciteteve të deponimit të ujërave dhe sistemet relativisht të pazhvilluara dhe joefiçiente të ujitjes. Kompanitë e ujërave aktualisht mbledhin vetëm 30% të të ardhurave nga uji që ato prodhojnë. Kjo normë është aktualisht e ulët dhe duhet të rritet urgjentisht meqenëse me normat aktuale kompanitë e ujërave nuk mund të kryejnë as mirëmbajtjen.

Ky problem pjesërisht mund t'i atribuohet humbjeve teknike, por shumica e humbjeve janë komerciale, p.sh. kyçeve jologjore, leximit të dobët të matësve. Masat për të zgjidhur aspektet komerciale janë tashmë të parapara si pjesë e Strategjisë së Kosovës për Ujërat. Plani i veprimit i kësaj strategjie parasheh një projekt prej 1.5 milionë euro në periudhën 2015-2020 e cila kombinon asistencën teknike dhe punën mediale për të rritur normën e pagesës për furnizimin me ujë duke lëshuar njoftime paraprake për mospaguesit, duke ofruar asistencë për ekonomitë familjare me të ardhura të ulëta, duke zbatuar një fushatë vetëdijësimi për publikun dhe duke siguruar zbatimin e veprimeve. Sa i përket kyçeve jologjore, strategjia parasheh një iniciativë pesëvjeçare për të identifikuar kyçjet jologjore, dënimet dhe lidhjen e konsumatorëve në sistem. Kjo iniciativë shihet si aktivitet themelor që do të merret nga furnizuesit rajonalë të ujërave nëpërmjet zbatimit më të mirë.

Sektorin e ujërave do të kërkojë **investime të konsiderueshme nga burimet publike** në infrastrukturë gjatë dekadave të ardhshme. Përderisa disa nga investimet mund të mbulohen nga përshtatja e tarifave (p.sh. rrjeti i shpërndarjes së ujit, trajtimi i kanalizimeve dhe ujërave të zeza), disa do të kërkojnë alokime buxhetore.

Një fushë ku posaçërisht nevojitet investimi publik është reduktimi i humbjeve në sistemin e furnizimit me trupin kryesor në zonat urbane dhe zgjerimi i rrjetit të furnizimit për ujin e pijshëm për të gjithë qytetarët e Kosovës. Strategjia e Kosovës për Ujërat parasheh që Qeveria do të ndërmerret një sistem renovimi që do të zgjidhte çështjet e mospagesës së mirëmbajtjes përderisa në të njëjtën kohë do të zgjeronte sistemin publik të furnizimit me ujë në 100% në zonat urbane dhe 90% në zonat rurale. Një vlerësim i përafërt thotë se renovimi total i rrjetit ekzistues të ujit të pijshëm në Kosovë do të kushtojë diku rreth 120-150 milionë euro, përderisa zgjerimi i rrjetit do të kushtonte rreth 125 milionë euro. Strategjia po ashtu ofron një rrjedhë indikative të investimeve vit për vit, me koston totale të programeve investuese për një periudhë pesëvjeçare prej 115 milionë eurosh. Strategjia parasheh që gjysma e kësaj shume do të vinte nga Qeveria dhe gjysma nga fondet e donatorëve.

Një fushë tjetër që ka nevojë për shumë investime publike është ndërtimi i objekteve të reja të deponimit të ujit (basenet). Aktualisht Kosova ka një kapacitet ekzistues prej rreth 525 milionë m³ të ujit ndërsa Strategjia e Ujërave synon nivelin e 1.150 milionë m³. Kostoja totale e vlerësuar e investimeve të nevojshme për të arritur këtë prag është 250 milionë euro. Sidoqoftë, problemi kryesor është se

basenet aktuale specifike që do të ndërtohen nuk janë identifikuar ende, megjithëse ekziston një listë paraprake/potenciale bazuar në një Master Plan të mëhershëm. Kjo është arsyeja se pse Strategjia e Ujërave parashih që katër vitet fillestare të strategjisë do të kalohen duke ndërmarrë Procesin e Planifikimit të Menaxhimit të Basenit të Lumenjve, i cili do të vlerësojë kërkesat për të ardhmen dhe nivelin në të cilin ato mund të arrihen me burimet ekzistuese, sikurse dhe studimet e fizibilitetit të baseneve të reja potenciale.

Në periudhën 2015-2017, është planifikuar një studim fizibiliteti (2 milionë euro) që do të shqyrtojë kërkesat afatgjatë (20 vite) për deponimin e ujërave dhe do të përgatis një plan të zhvillimit që përfshin projektet konceptuale. Një projekt i ri do të punojë me më shumë detaje që të identifikojë projektet prioritare të baseneve të lumenjve të identifikuar në studimin e fizibilitetit, të përgatis planet e zbatimit si dhe projektimin dhe tenderimin. Ky projekt do të kushtojë po ashtu 2 milionë euro. Investimet aktuale në objektet e reja të deponimit parashihen të fillojnë në vitin 2018, duke marrë rreth 10 milionë euro në vit. Në periudhën pesëvjeçare (2015-2020), rrjedhat indikative në Strategjinë e Ujërave parashohin 34 milionë euro investime në deponimin e ujërave, 75% të të cilave janë të financuara nga donatorët.

Duhet të përgatitet dhe miratohet një **strategji për zhvillimin e sistemit të ujitjes** përgjatë Kosovës në mënyrë që të ndihmohet rritja e produktivitetit në sektorin e bujqësisë. Kjo do të rezultojë në rritjen e potencialit të punësimit dhe eksportit të bujqësisë dhe do të sjell mundësi të reja për rritjen ekonomike në zonat rurale. Strategjia po ashtu do të zgjidh çështjen e efijencës së sistemeve të ujitjes, meqenëse ato janë duke shfrytëzuar një pjesë të madhe të burimeve ujore. Me vendosjen e sistemit të ujitjeje, kjo do të bëhet problem, për shkak të mungesës së ujit në Kosovë.

Tabela 2 – Masa #4.03.1: Zgjidhja e rrezikut që rezulton nga mungesa e ujit

Masa #4.03.1	Aktiviteti	Produkti	Rezultati
Zgjidhja e rrezikut që rezulton nga mungesa e ujit	Reduktimi i humbjeve teknike dhe komerciale të kompanive rajonale të furnizimit me ujë	- Njofftimi i mospaguesve - Asistenca ndaj ekonomive familjare me të ardhura të ulëta - Fushata për vetëdijesimin e publikut - Veprimet për zbatim	Rritja e mbledhjes së të ardhurave nga 30% në 80% në vitin 2021
	Riparimi i rrjeteve të furnizimit dhe zgjerimi i mbulimit urban dhe rural	- Programi i investimeve që vlen 115 milionë euro në pesë vitet e para për të riparuar tubacionet e vjetra në zonat urbane dhe për të ndërtuar të reja në zonat rurale	Reduktimi i ujërave pa të ardhura (humbjeve) nga 60% në 30% të ujit të prodhuar
	Kryerja e studimeve të fizibilitetit dhe fillimi i ndërtimit të vendit të parë të deponimit të ujit	- Programi i investimeve me vlerë prej 19 milionë euro	Rritja e normës së kyçeve të ujit nga 76% në 2015 deri në 84% në 2021
	Zgjerimi dhe bërja më efijente e sistemit të ujitjes	- Identifikimi i nevojave të deponimit të ujërave - Finalizimi i planeve të zhvillimit dhe projekteve konceptuale për vendet e reja të deponimit	Zgjerimi i mbulimit nga rrjeti i ujitjes nga 12000 hektarë në 29000 hektarë
			Reduktimi i “normës së aplikimit” të ujitjes nga 11500 m ³ në 8000 m ³

Aktualisht, hapësira totale e ujitur në Kosovë është 12000 hektarë. Strategjia e Kosovës për Ujërat konsideron që arritja e një caku prej 29000 hektarësh në pesë vite është realiste, megjithëse kjo do të ishte mjaft e ulët në krahasim me mesataren me metër katror të shumicës së vendeve të ujitura në Evropën jugore. Sa i përket efijencës, Kosova po ashtu ka një “normë aplikimi” prej rreth 11500 m³/hektar, e cila është shumë më e larë se mesatarja 5000-7000 m³/hektar e vendeve anëtare të

.....

BE-së. Strategjia e Ujërave thotë që nëse Kosova ia arrin të përmirësojë eficiencën afërsisht në këtë nivel, kjo do të mënjanonte kërkesën e tepërt nga zgjerimi i rrjetit të ujitjes, pra duke mos vënë ndonjë barrë të madhe mbi furnizimin e kufizuar të ujit. Për të arritur këtë qëllim të dyfishtë të eficiencës dhe rrjetit të zgjeruar, strategjia parasheh një program investimesh shumëvjeçare, që në pesë vitet e para të tij parasheh shpenzime në vlerë prej 19 milionë eurosh.

2. Shfrytëzimi dhe menaxhimi i qëndrueshëm i pyjeve

Për të vendosur **strukturë më eficiente të pronësisë** të fokusuar në qëndrueshmërinë afatgjatë dhe menaxhimin e duhur të pyjeve, është e nevojshme për të përkrahur krijimin e **shoqatave të pronarëve**, të cilat do të sillnin së bashku pronarët individualë të pyjeve në mënyrë që të harmonizohen interesat e tyre. Shoqata do të organizohet si OJQ (sipas Asociacionit të Komunave) dhe do të pranonte financim publik për t'u angazhuar në përkrahjen e politikave, rrjetëzimin dhe ndarjen e informatave ndërmjet anëtarëve për sa i përket praktikave më të mira. Ajo do të punonte ngushtë me Departamentin e Pylltarisë dhe Agjencinë e Pyjeve të Kosovës.

Sidoqoftë, efektiviteti i këtij koordinimi duhet të varet mbi procesin e **ristrukturimit dhe/apo privatizimit të Ndërmarrjeve të Pyjeve në Pronësi Shoqërore**, meqenëse pyjet publike operojnë si NPP. Alternativat për këtë janë dhënë në notën e politikave për “Zhbllokimin e pasurive”.

Sa i përket qëndrueshmërisë, **planet e menaxhimit të pyjeve** duhet të jenë më të shpërndara për tokat pyjore publike dhe kriteret e shfrytëzimit të zhvilluara për ato private. Në linjë me Politikën dhe Strategjinë për Pylltarinë në Kosovë (2010-2020), Kosova duhet të krijojë plane të menaxhimit të pyjeve për një hapësirë rreth 30000 hektarë në baza vjetore për tokat pyjore publike. Kjo nënkupton që në këtë periudhë ndërmjet viteve 2016-2020 (katër vite) planet e menaxhimit të pyjeve do të zhvillohen për afro 120000 hektarë (me një fokus të veçantë në zonat e mbrojtura – 59000 ha) ose 40% të totalit të tokave pyjore publike (278880 ha).

Meqenëse disa nga këto pyje publike pritet të privatizohen, planet e menaxhimit duhet të vendosin kriteret e veçanta për planifikim që duhet t'i kenë operatorët privatë edhe pas privatizimit. Kosova po ashtu duhet të krijojë kriteret e veçanta të menaxhimit për tokat pyjore që aktualisht janë private (185000 ha). Në total kjo nënkupton adoptimin e **planeve ose kriterëve të shfrytëzimit për rreth 65% të tokave pyjore në Kosovë në periudhën 2016-2020**.

Planet për menaxhimin e pyjeve për tokat pyjore publike dhe kriteret speciale për ato private do të zgjidhin një numër çështjesh të ndërlidhura me menaxhimin dhe qëndrueshmërinë e pyjeve. Por rregulli i artë në të dy këto do të ishte që vëllimi vjetor i shfrytëzimit nuk duhet të jetë më i lartë se 60% të rritjes së parashikuar vjetore. Ky është një parim i vendosur në Strategjinë e Pylltarisë. Është me rëndësi thelbësore që të parandalohet degradimi i mëtutjeshëm i pyjeve para se menaxhimi më i mirë (që rezulton nga planet për menaxhimin e pyjeve dhe privatizimet) të sigurojë pastrimin e vendeve dhe ripyllëzimin.

Për këtë arsye, **reduktimi i shfrytëzimit ilegal** do të jetë themelor për eliminimin e humbjeve komerciale ndaj shtetit, e gjithashtu edhe pronarëve privatë. Përfundimisht, hapësira kryesore e intervenimit për vitet e ardhshme është zbatimi më i mirë i ligjit, meqenëse kapacitetet e Agjencisë së Pyjeve të Kosovës janë të dobëta për këtë rol dhe ajo është fuqizuar në mënyrë të pamjaftueshme gjatë ballafaqimit me prerësit ilegalë.

Prandaj është thelbësore themelimi i **një task force speciale** me Policinë e Kosovës, Forcën e Sigurisë së Kosovës, Këshillin Prokurorial dhe Këshillin Gjyqësor – të kryesuar nga Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural – që do të delegonte po ashtu disa përgjegjësi te agjencitë për të zbatimin e ligjit dhe gjykatat. Synim i task forcës do të ishte që të reduktojë gradualisht praninë e shfrytëzimit ilegal përgjysmë, nga 40% të pyjeve publike në 20%, dhe nga 29% në 15% të pyjeve private. Nevojitet po

ashtu **një fushatë e informimit publik** për të nënvizuar pasojat ligjore (gjobat) që janë tashmë të parashikuara në Ligjin për Pyjet. Nevojitet po ashtu **një program për ndërtimin e kapaciteteve** për të fuqizuar kapacitetet e stafit të APK-së në aftësitë për menaxhimin e pyjeve, ashtu që të merr përgjegjësi të plotë në periudhë afatgjatë.

Një fushë tjetër që ka nevojë për vëmendjen e qeverisë është **organizimi i tregut**. Duhet të lëshohen lejet me procedura të hapura, të ketë kontrata afatgjata dhe të ketë çmime të ndershme. Kjo do të bënte që të kishte ndryshime në Ligjin për Pyjet dhe aktet ekzistuese nënligjore. Tregu i tanishëm i drurit, i fragmentuar, nuk është duke lejuar sektorin privat (personat individualë që zotërojnë pyje, kompanitë dhe ndërmarrësit e përfshirë në operimin e pyjeve dhe/apo përpunimin e drurit në shkallë të vogël) për të zhvilluar çfarëdo aktivitetesh me vlerë të shtuar që përkrahin ekonominë lokale. Organizimi më i mirë i tregut do të lejonte industrinë përpunuese sikurse prodhuesit e mobilieve ose industrinë në ngritje të veletit në Kosovë dhe rajon që të sigurojë stabilitet dhe sasi të madhe të furnizimit me lëndë të para.

Tabela 3 – Masa #4.03.3: Shfrytëzimi i qëndrueshëm dhe menaxhimi i pyjeve

	Aktiviteti	Produkti	Rezultati
Masa #4.03.3 Shfrytëzimi i qëndrueshëm dhe menaxhimi i pyjeve	Koordinimi më i mirë ndërmjet pronarëve të pyjeve	Themelimi i asociacionit të pronarëve të pyjeve	Përmirësimi i koordinimit dhe harmonizimi i interesave ndërmjet pronarëve të pyjeve
	Privatizimi i NPP të pyjeve	Stimuj të përmirësuar për menaxhim më të mirë të pyjeve.	Praktika më të qëndrueshme të menaxhimit të pyjeve dhe të orientuara drejt tregut
	Zhvillimi i planeve për menaxhimin e pyjeve dhe/apo kritereve speciale të shfrytëzimit	Krijimi i planeve të menaxhimit të pyjeve dhe/apo kritereve për speciale për shfrytëzim për 65% të tokave pyjore në Kosovë	Vëllimi i shfrytëzimit jo më i madh se 60% të rritjes së parashikuar vjetore
	Masa më të fuqishme kundër prerësve ilegalë	- Themelimi i një task force me agjencitë për zbatimin e ligjit për të përkrahur përpjekjet e APK-së kundër prerjeve ilegale të drunjëve	Reduktimi i pranisë së shfrytëzimit ilegal nga 40% në 20% të pyjeve publike
	Organizimi më i mirë i tregut	- Fushata për informim publik - Programi për ndërtimin e kapaciteteve për APK - Modifikimi i ligjeve dhe akteve nënligjore në sektorin e pylltarisë për të siguruar transparencën dhe kontrata më të gjata në lejet e dhëna	Reduktimi i pranisë së shfrytëzimit ilegal nga 29% në 15% të pyjeve private

3. Shfrytëzimi i plotë i potencialit të minierave

Aktualisht potenciali i sektorit të minierave është i bllokuar kryesisht për shkak të dy arsyeve. E para janë **strukturat e pronësisë** të pacaktuara që janë duke rezultuar në investime të ulëta dhe shfrytëzim nënoptimal të burimeve natyrore. Qeveria duhet të fokusohet pra kryesisht në transformimin dhe privatizimin e minierave më të mëdha me potencial më të madh (Trepça) që mund të ndikojnë në rritje të menjëhershme të PKB-së dhe produktivitetit, megjithëse jo domosdoshmërisht punësimit. Zgjidhja më e detajuar për këto çështje paraqitet në notën e politikave të Zhbllokimit të Pasurive Strategjike të SKZH.

Në të njëjtën kohë, Qeveria duhet të zgjidh mangësitë në **rregullimin e tregut dhe kapacitetin administrativ** të organeve mbikëqyrëse (KPMM). Këto sfida nuk janë aq të lidhura me kornizën ligjore,

.....

e cila është tashmë e zhvilluar, por më tepër me burimet njerëzore dhe transparencën dhe parashikueshmërisë së procedurave. Masat që duhet të ndërmerren për të përmirësuar performancën e administratës publike, duke përfshirë agjencitë e pavarura sikurse KPMM, janë paraqitur në notën e politikave për “Udhëzimet për realizimin” e SKZH.

Strategjitë aktuale të qeverisë janë fokusuar mbi zhvillimin e sektorit të minierave pa integrimin e saj në ekonominë e Kosovës. Përveç eksportimit të lëndëve të para, Kosova duhet të fokusohet në zingjirin e vlerës së shtuar dhe të aspirojë **lidhjen e minierave me zhvillimin e shtyllave industriale**. Teknologjia moderne e përpunimit të mineraleve është e sofistikuar dhe kërkon kapital intensiv, pra zakonisht e përqendruar në lokacione specifike ku ato mund të zhvillohen rreth minierave në shtyllat industriale. Pra, për shfrytëzimin e plotë të potencialit të minierave të Kosovës, parakushte janë **investimet e konsiderueshme dhe njohuria e huaj teknike dhe menaxheriale**. Kjo më së miri arrihet nëpërmjet marrëveshjeve me përfitim të dyanshëm me investuesit strategjikë (p.sh. Trepça). Por formimi i shtyllave nënkupton po ashtu planifikim të kujdesshëm afatgjatë dhe koordinim ndërsektorial, investime të caktuara publike në infrastrukturë, kapital njerëzor dhe aftësi, sikurse dhe involvimin e kompanive lokale që mund të përkrahin industrinë e minierave me aktivitete plotësuese. Alternativat më të detajuara për zhvillimin e shtyllave janë paraqitur në Analizën e Politikave rreth ‘Unleashing Clusters’ të SKZH.

Për të përkrahur **potencialin eksportues të industrisë së minierave** dhe shtyllave industriale që formohen përreth saj, **investimi në infrastrukturë** duhet të drejtohet rreth korridoreve kryesore hekurudhore të eksportit. Alternativat më të detajuara për zhvillimin e shtyllave janë paraqitur në notën për infrastrukturën e SKZH.

Lidhjet ndërsektoriale të strategjisë së minierave **janë relativisht të dobëta**. Strategjia është fokusuar kryesisht mbi sfidat brenda sektorit të minierave dhe përjashton rëndësinë që minierat kanë për zhvillimin e industrive të tjera. Në të njëjtën kohë strategjia e minierave nuk është e fokusuar mbi mundësitë për të rritur eksportet. Shembuj të mirë të këtyre mangësive është sektori i energjisë, ku minierat e qymyrit luajnë rol të rëndësishëm. Përderisa vetë linjiti nuk është artikull i mirë për eksport, kur përdoret si burim për prodhimin e energjisë elektrike, ai bëhet artikull shumë i vlefshëm i eksportit – nëpërmjet transportit. Duhet të bëhen më të qarta lidhjet më të ngushta ndërmjet strategjisë së minierave dhe asaj të strategjisë, për më tepër kur të dy sektorët janë nën të njëjtën ministri (MZHE). Alternativat më të detajuara për zhvillimin e shtyllave janë paraqitur në notën për energjinë e SKZH.

.....

Lista e Tabelave

Tabela 1 - Kostot e vlerësuara për masat e infrastrukturës së ujërave 12

Tabela 2 – Masa #4.03.1: Zgjidhja e rrezikut që rezulton nga mungesa e ujit..... 15

Tabela 3 – Masa #4.03.3: Shfrytëzimi i qëndrueshëm dhe menaxhimi i pyjeve 17

.....

Bibliografia

Strategjia Kombëtare e Kosovës për Ujërat 2015-2038, Versioni draft


Një Strategji e re për Ujitjen në Kosovë, Versioni draft

Dokumenti i Politikave Qeveritare për Ujërat, Këshilli Ndërministror për Ujërat

Dokumenti Politik dhe Strategjik për Zhvillimin e Pylltarisë 2010-2020, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, 2009

Inventari Kombëtar i Pyjeve të Kosovës 2012, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, 2013

Strategjia e Minierave e Republikës së Kosovës 2012-2025, miratuar nga Qeveria në vitin 2012



● KU MUND TË MARRIM MË TEPËR INFORMATA?

Procesi i përgatitjes së PLAN-it është koordinuar nga
Zyra për Planifikim Strategjik e Zyrës së Kryeministrit.

Për më tepër informata mund të kontaktoni në:
info@plan-rks.org

www.plan-rks.org